


TaxNews

June 2020
Qershor 2020



Deloitte.

Në kuadër të kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", në website-n zyrtar të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit janë publikuar së fundmi dy Udhëzues:

1. Udhëzuesi për Raportin e Performancës së Organizatave Jofitimprurëse (OJF) në Shqipëri, dhe
2. Udhëzuesi për Përgatitjen e Raportit Jofinanciar për njësitë e mëdha me interes publik.

Më poshtë paraqesim shkurtimisht informacionin që Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit udhëzon të përshihet përkatësisht në këto raporte.

RAPORTIT I PERFORMANCËS SË OJF-VE

Detyrimin për përgatitjen e raportit e kanë ato OJF të cilat kanë në pasqyrat e tyre financiare një vlerë totale aktivesh ose të ardhurash mbi 30 milionë lekë.

Raporti duhet të ofrojë një përmbledhje të drejtë, të ekuilibruar dhe të kuptueshme të strukturës së OJF-së, qëllimin për krijimin e saj, objektivat, aktivitetet, performancën dhe pozicionin financiar, si dhe impaktin e sjellë. Ky raportim duhet të sigurojë një kontekst brenda të cilit të interpretohen të dhënat e paraqitura në pasqyrat financiare të OJF-së.

Raporti depozitohet dhe publikohet së bashku me pasqyrat financiare dhe raportet e tjera dhe në faqen e internetit të OJF-së.

In the context of the requirements of Law no. 25/2018 "On accounting and financial statements", the National Accounting Council has recently published in its official website two guidelines:

1. Guideline on the Performance Report of Non-for-Profit Organizations (NPOs) in Albania, and
2. Guideline for the preparation of the Non-Financial Report for large public interest entities.

We briefly present below the information that the National Accounting Council instructs to be respectively included in the reports.

PERFORMANCE REPORT FOR NPOs

All NPOs that present in their financial statements a total amount of assets or income of at least ALL 30 million have the obligation to prepare this report.

The report should provide a fair, balanced and understandable summary of the structure of the NPO, its goals, objectives, activities, performance and financial position, as well as the impact brought. This reporting should provide a framework within which to interpret the data presented in the NPO's financial statements.

The report is to be filed and published along with the financial statements and other additional reports on the NPO's official website.

Përmbajtja e Raportit

Raporti mund të paraqitet i ndarë në disa kapituj si në vijim:

- Objektivat dhe aktivitetet – me informacione në ndihmë të përdoruesit të raportit për të kuptuar mënyrën si OJF synon të arrijë qëllimet e saj, aktivitetet për të arritur këto qëllime dhe rezultatet faktike të këtyre aktiviteteve.
- Arritjet dhe performanca - me një përmbledhje të arritjeve kryesore të OJF-së për periudhën e raportimit duke identifikuar dhe ndryshimet e sjella nga aktiviteti i OJF-së në mjedisin ku ajo operon.
- Raportimi financiar – me një përmbledhje të pozicionit financiar të OJF-së në fund të periudhës së raportimit, burimet kryesore të financimit në periudhën raportuese dhe mënyrën si këto burime të ardhurash janë përdorur për arritjen e qëllimeve të OJF-së. Ky informacion mund të plotësohet dhe me tregues të rëndësishëm jofinanciarë. Fondet (grantet) e dhëna nga OJF-të janë aspekt i rëndësishëm i punës së shumë prej tyre për rrjedhojë, nëse ky informacion nuk paraqitet në shënime shpjeguese të pasqyrave financiare, duhet të përfshihet në raport.
- Struktura, drejtimi dhe mbikqyrja – me informacion lidhur me organizimin dhe drejtimin e OJF-së, përfshirë mënyrën e mbikqyrjes.

Struktura e mësipërme gjendet gjithashtu e listuar në formë tabelare si Aneksi 1 i këtij Udhëzuesi.

Content of the report

The report can be presented into several chapters as follows:

- Objectives and activities – with information to help the report’s users to understand how the NPO aims to achieve its goals, activities performed to achieve the goals and the actual results of such activities;
- Achievements and performance – with a summary of the main achievements of the NPO for the reporting period, identifying the changes brought by the activity of the NPO in the environment where it operates;
- Financial reporting – with a summary of the financial position of the NPO at the end of the reporting period, the main funding sources in that reporting period and how they have been used to achieve the objectives of the NPO. This information can be supplemented with other important non-financial indicators. Funds (grants) donated by NPOs are a key aspect of their work, as such, if this information is not presented in the relevant explanatory notes of the financial statements, it should be included in the report;
- Structure, management and supervision – with information related to the organization and management of the NPO, including the method of supervision.

The above structure is also listed in tabular form as Annex 1 of this Guideline.

RAPORTI JO-FINANCIAR

Kërkesa për përgatitjen e raportit jo-financiar zbatohet për njësitë e mëdha që klasifikohen si njësi me interes publik dhe kanë më shumë se 500 të punësuar. Ky raport duhet të përfshihet në raportin e ecurisë së veprimtarisë. Udhëzuesi paraqet praktikën më të mira lidhur me informacionin material që duhet të përmbajë raporti në mënyrë që të pasqyrojë një pamje të drejtë të njësisë deri në atë masë që i nevojitet palëve të interesuara. Palët e interesuara mund të përfshijnë investitorët, punonjësit, konsumatorët, furnitorët, klientët, autoritetet etj.

Materialiteti i një informacioni vlerësohet në bazë të kontekstit. Çështjet që duhen konsideruar për t'u përfshirë në raport janë specifike për rrethanat e çdo njësie duke konsideruar situatat konkrete dhe faktorët sektorialë. Njësitë mund të raportojnë për një gamë të gjërë çështjesh bazuar në analizën e secilës njësi mbi relevancën e atij informacioni për të kuptuar zhvillimin, performancën, pozicionin dhe ndikimin e njësisë.

Informacioni i paraqitur në raport duhet të jetë i drejtë dhe i paraqitur në mënyrë të paanshme duke përfshirë aspektet e favorshme por edhe ato të pafavorshme. Në raport duhet të dallohen qartë faktet nga pikëpamjet, opinionet ose interpretimet.

Në raport duhet paraqitur informacion material edhe për kategori të caktuara të çështjeve si ato mjedisore, sociale dhe të punonjësve; respektimin e të drejtave të njeriut; çështjet anti-korrupsion, etj.

NON-FINANCIAL REPORT

The requirement to prepare a non-financial report applies to large entities that are classified as public interest entities and have more than 500 employees. This report should be included in the activity progress report. The guideline presents the best practices regarding the material information to be included in the report in order to reflect a fair picture of the entity to the extent needed by stakeholders. Interested parties may include investors, employees, consumers, suppliers, customers, authorities, etc.

The materiality of an information is evaluated on a context basis. The issues that should be considered to be included in the report are specific to the circumstances of each entity considering existing situations and sectorial considerations. Entities are allowed to report on a wide range of issues based on the analysis of each entity and the relevance of that information to understand the development, performance, position and impact of the entity.

The information presented in the report must be fair and unbiased, including both the favorable and the unfavorable aspects, taking into account all possible and reliable inputs. The report should clearly distinguish the facts from the views, opinions or interpretations.

The report should provide material information on certain categories of issues such as environmental, social and employees issues; respect of human rights; anti-corruption issues, etc.

Raporti jo-financiar është i pritshëm të jetë në përputhje me elementet e tjerë të raportit të ecurisë së veprimtarisë si dhe konsistent me raporte të tjera.

Ndër të tjera, raporti pritet të ofrojë edhe informacion mbi:

- modelin e biznesit, pra mënyrën se si njësia gjeneron dhe ruan vlerën përmes produkteve ose shërbimeve të saj;
- politikat dhe proceset e due diligence që zbaton;
- rreziqet kryesore dhe mënyrën se si ato identifikohen, manaxhohen dhe shmangen;
- treguesit kryesorë të performancës jo-financiare të njësisë.

The non-financial report is expected to be consistent with the other elements of the performance progress report and consistent with the other reports.

Amongst others, the report is expected to also provide information on the:

- business model, i.e. how the entity generates and maintains value through its products and services;
- policies and due diligence processes it undertakes;
- key risks and how they are identified, managed and avoided;
- key non-financial performance indicators of the entity.

Deloitte Contacts

Olindo Shehu, CPA

Partner | Tax & Legal Services
Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Faik Konica",
Ndërtesa nr.6, Hyrja nr. 7
1010, Tirana, Albania
Mob: +355 68 60 33 116
E-mail: oshehu@deloitteCE.com

Disclaimer:

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 312,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.